

Deri te:

## KËSHILLI MËSIMOR-SHKENCOR I FAKULTETIT FILOLOGJIK

Në pajtim me nenin 173 të Ligjit të arsimit të lartë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 82/2018), nenit 32, 34, 35 dhe 36 të Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurës për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës nr. **01/4309/2** e datës **01.XII.2021**, dhe në bazë të Konkursit për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin **Gramatika, Semantika, Semiotika, Sintaksa** (Morfologji e gjuhës angleze I dhe II), **Tjetër** (Shkrim akademik III dhe IV) (64018, 64029 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), të shpallur më **22.05.2024** në gazetën ditore “Koha” dhe “Slloboden Peçat” dhe në web faqen e Universitetit të Tetovës: <https://unite.edu.mk/>, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen e mbajtur më **20.06.2024**, solli Vendim me nr. **18-408/1** të datës **21.06.2024**, me të cilin formohet Komisioni recensues në përbërje:

1. **Prof. dr. Florim AJDINI** (kryetar) – profesor ordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës;
2. **Prof.dr. Isa SPAHIU** (anëtar) – profesor ordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës,
3. **Prof.dr. Berton SULEJMANI** (anëtar) – profesor ordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës.

Duke falënderuar për besimin e dhënë, Komisioni recensues dorëzon këtë:

### REF ER AT

PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE NË LËMIN GRAMATIKA, SEMANTIKA, SEMIOTIKA, SINTAKSA (MORFOLOGJI E GJUHËS ANGLEZE I DHE II), TJETËR (SHKRIM AKADEMIK III DHE IV) (64018, 64029 NGA KLASIFIKIMII SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMENJVE SHKENCORË-HULUMTUES SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR TË FRASKATIT) NË PROGRAMIN STUDIMOR GJUHË DHE LETËRSI ANGLEZE TË FAKULTETIT FILOLOGJIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Në konkursin e shpallur për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin **Gramatika, Semantika, Semiotika, Sintaksa** (Morfologji e gjuhës angleze I dhe II), **Tjetër** (Shkrim akademik III dhe IV) (64018, 64029 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas *Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit*) në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Angleze, është paraqitur vetëm kandidati **Prof.dr. Arburim Iseni**.

### ***Të dhëna biografike dhe arsimimi***

Kandidati Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni është lindur më datë 15.05.1976 në fshatin Mateç, komuna e Likovës.

### ***Arsimimi***

Shkollën fillore e ka kryer në fshatin Mateç, kurse shkollën e mesme në gjimnazin e Kumanovës. Studimet deridiplomike i ka kryer më 29 shtator 1999, në kuadër të Fakultetit Filologjik, Universiteti i Tetovës, Tetovë, Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze me notën mesatare **9.18**. Studimet pasdiplomike i ka kryer 05.06.2006, në Universitetin Shtetëror të Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, dega e gjuhës dhe letërsisë angleze, drejtimi i gjuhësisë me notën mesatare **9.50**, me titull “*Error Analysis in Albanian Speakers’ English Writings*” dhe ka marë gradën shkencore *Magjistër i Shkencave Filologjike*. Studimet e doktoraturës i ka kryer në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit, Dega e Gjuhës Angleze në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, më 23.08.2013 dhe ka mbrojtur me sukses tezën e disertacionit me titull: “*Albanian Students’ Errors in Spoken and Written English and the Role of Error Correction in Assessment and Self-Assessment*” dhe ka fituar gradën shkencore *Doktor i Shkencave Filologjike*.

Doktoraturën e dytë e ka kryer në Universitetit Shën Kirili dhe Metodi pranë Fakultetit Filologjik “Blazhe Koneski” në Shkup me temën: „*Сличностите и разликите меѓу Канонот на Лека Дукаѓини и Ареалот на Западните кодови*“.

Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni që nga diplomimi i tij më 29.09.1999 e në vazhdim është pedagog i gjuhës angleze në Fakultetin Filologjik të Universitetit Shtetëror të Tetovës, pranë programit studimor Gjuhë dhe Letërsi Angleze. Në vitet 2001-2003 ka qenë ushtrues detyre përgjegjës i departamentit të gjuhës dhe letërsisë angleze dhe gjithashtu edhe në periudhën 2009–2011 pranë këtij universiteti. Që nga viti 1999 ka ligjeruar lëndët, si vijon: Metodologjia e Mësimdhënies së gjuhës angleze; Historia e gjuhës angleze; Gjuhë bashkëkohore angleze; Fonetika dhe Fonologjia e gjuhës angleze; Bazat e gramatikës së gjuhës angleze; Morfologjia e gjuhës angleze; Sintaksa e gjuhës angleze; Leksikologjia e gjuhës angleze; Shkrimi akademik; Letërsia angleze; Stilistika e gjuhës angleze; Hyrje në studimet e gjuhës angleze; Probleme të veçanta në nxënien e gjuhës angleze; Zhvillimi i gjuhës standard angleze.

Aktualisht ligjeron lëndët: Morfologji e gjuhës angleze I, Morfologji e gjuhës angleze II, dhe Shkrim akademik III, Shkrim akademik IV.

Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni flet rrjedhshëm gjuhën gjermane, maqedone dhe gjuhën serbe. Ka njohuri themelore të gjuhës frenge. Kandidati ka publikuar studime në shumë revista lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.

### ***Veprimtaria shkencore dhe botuese e kandidatit Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni***

**Sasia e punës shkencore** e kandidatit Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni paraqitet e konsiderueshme dhe e larmishme. Kandidati Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni ka një veprimtari të gjërë kërkimore shkencore dhe një aktivitet të pasur botues.

- Kryetar dhe themelues i Institutit për gjuhë angleze dhe studime Amerikane, Tetovë – Maqedoni.
- Anëtar i grupit hulumtues për mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë pranë Fakultetit të Edukimit, Universiteti Murcia, Spanjë.
- Redaktor përgjegjës i revistës ndërkombëtare **Journal of Language and Linguistics in Society (JLLS)** ISSN 2815-0961
- Redaktor përgjegjës dhe themelues i revistës ndërkombëtare **ANGLISTICUM**. E-ISSN: 1857-8187. P-ISSN: 1857-8179
- Ka qenë kryeredaktor i revistës ndërkombëtare **IDEST** dhe pastaj edhe i **SUT Scientific Observer**.
- Anëtarë i komitetit redaktues në revistën prestigjioze ndërkombëtare **PORTA LINGUARUM** ISSN: 16977467

- Anëtar i bordit redaktues në revistën ndërkombëtare **Language Testing in Asia** ISSN: 2229-0443
- Ka qenë anëtarë në redaksinë e revistës **Vizione** 1857-9221
- Anëtar i këshillit redaktues pranë revistës prestigjioze ndërkombëtare **American Journal of Educational Research** ISSN: 2327-6150
- Anëtarë i këshillit redaktues pranë revistës prestigjioze ndërkombëtare **Journal of Education and Practice** ISSN: 2310-3868
- Redaktor i revistës ndërkombëtare për edukim **Journal of Education** ISSN: 2347-8225
- Redaktor i revistës ndërkombëtare për edukim **ICT & Innovations in Education** ISSN: 2321-7189
- Anëtar në redaksinë e revistës ndërkombëtare për shkencë shoqërore dhe humane **American Journal of Social Issues and Humanities** ISSN: 2276-6928
- Recensues në redaksinë e revistës ndërkombëtare **Teaching English with Technology** ISSN 1642-1027
- Anëtar në redaksinë e revistës ndërkombëtare për shkencë dhe teknologji inovative **Journal of Science and Innovative Technologies** e-ISSN 2616-4418; p-ISSN: 2521-1447

Studimet dhe hulumtimet e tij janë të shumta e të vazhdueshme; në punët e tij gërshetohet përvoja botërore me mendimin personal. Kualifikimet e kurset e shumta, kontaktet me arritjet bashkëkohore e botimet e fundit dhe pjesëmarrja në konferenca shkencore në Europë, sidomos në Angli, kanë ngritur dukshëm nivelin shkencor të veprave e të prodhimit shkencor të tij. Ka botuar shumë artikuj në revista shkencore jashtë vendit, të cilësisë me ISSN, si dhe artikuj në revista të ndryshme shkencore me faktor impakti, dhe është fitues i dy çmimeve nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës pranë Republikës së Maqedonisë për këso lloj publikimesh.

Për t'u theksuar është pjesëmarrja e tij aktive me dhjetra kumtesa e referate në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare në Spanjë, Itali, Gjermani, Angli, Shqipëri, Bruksel, Sicili, Kosovë, Mal të Zi, Bullgari, etj; bashkëpunimi i shumëanshëm me mjaft universitete të huaja, amerikane dhe europiane; botimi i shumë kumtesave dhe artikujve në organe botuese të shumta europiane, përfshirë edhe revistat tona universitare. Si rezultat i këtij aktiviteti ka referuar apo prezantuar 7 tema e kumtesa në konferenca e takime shkencore ndërkombëtare jashtë vendit, si dhe 5 kumtesa e prezantime në konferenca e takime shkencore brenda vendit. Ka marrë pjesë në 13 konferenca shkencore jashtë vendit si dhe është trainuar në 12 seminare e workshop-e nga një javë deri 2 muaj në Maqedoninë e veriut dhe në vende të ndryshme të Evropës.

Kandidati Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni ka kryer me sukses dy kurse mësimi në distancë për zhvillimin e tij profesional të udhëhequr nga Prof.dr. Armando Lopez Valero pranë Universitetit të Murcias në Spanjë me temën "*Ongoing Story Dramatization and School for Children Education at Primary and Secondary Level*" dhe u shpërblye me certifikatë prej 3 kredi ECTS. Menjëherë pas mbarimit të kursit të parë, kandidati Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni e kishte filluar edhe kursin e dytë me temën "*Processes and Strategies for Childhood Education at Primary and Secondary Level*" ku poashtu ishte shpërblyer me certifikatë prej 3 kredi ECTS. Ka fituar çmimin për cilësi më të mirë për botimin e revistës IDEST pranë departamentit të anglishtes nga COLLEGE READING ASSOCIATION me seli ne Utah, USA.

Veprimtaria e gjërë kërkimore-shkencore e Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni është fryt i një pune të gjatë e intensive, i një praktike mësimdhënëse shumë vjeçare, i njohjes së disa gjuhëve të huaja, i kualifikimit e specializimit të vazhdueshëm, është fryt i përditësimit të njohurive të tij shkencore me përvojën më të përparuar botërore në fushën e mësimdhënies së gjuhës angleze; ku ai sjell me kompetencë të lartë përvojën anglo-amerikane në mësimdhënien e anglishtes si gjuhë e huaj, konkretisht gramatikën e gjuhës angleze, duke hapur shpesh rrugë të reja në këtë fushë. Puna shkencore e kandidatit ka një shtrirje mjaft të gjerë. Ajo përfshin drejtime të ndryshme të gjithë sistemit arsimor kombëtar, duke përfshirë si arsimin parauniversitar ashtu edhe atë universitar. Ka kryer studime, ka referuar e botuar për drejtime të tilla si metodologjitë e të mësuarit, metodologjitë e mësimi të gjuhës së huaj, për probleme të ndryshme të edukimit, etj. Cilësia e punës shkencore të kandidatit Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni është e një niveli të lartë, frut i këmbënguljes dhe skrupulozitetit të tij në kërkime, vëzhgime, konsulta e studimin e literaturës. Në tekstet, artikujt e

botuar si dhe në referatat dhe kumtesat e mbajtura vihet re cilësia e metodologjive të përdorura dhe e gjykimit shkencor. Veçojmë sidomos tekstet: 1. *A Practical English Grammar* 2. *The Origin and History of the English Language* 3. *Modern English Grammar*. Veprimtaria e kandidatit Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni përfaqëson një kontribut të rëndësishëm me dimensione kombëtare në të gjitha ciklet e arsimit shqiptar. Me studimet dhe botimet e tij ai ka dhënë një ndihmesë të rëndësishme në hartimin e standardeve të mësimi të gjuhëve të huaja, në përmirësimin e metodologjive të mësimdhënies së gjuhëve të huaja në tërësi dhe gramatikës së gjuhës angleze në veçanti, si për arsimin parauniversitar, ashtu edhe atë universitar. Impakti i punës shkencore të kandidatit shoqërohet me një impakt të rëndësishëm në fushën e edukimit (hartimi i kurrikulave), si dhe në formimin e mësuesve, duke u shtrirë në të gjitha ciklet e arsimit.

Karakteret udhëheqës i veprimtarisë së kandidatit Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni është i manifestuar në disa projekte, në punën e tij si drejtues i njëjësive universitare, si përgjegjës departamenti e më pas si koordinator fakulteti për ECTS dhe koordinator për studimet e ciklit të dytë–Master. Gjithashtu Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni ka udhëhequr me cilësi shumë diploma universitare të nivelit Bachelor, si dhe dhjetëra diploma të nivelit Master pranë Universitetit të Tetovës.

### ***Vlerësimi Metodiko Shkencor***

Komisioni i profesorëve për vlerësimin e procedurës së fitimit të titullit *Profesor ordinar* pasi kishte vëzhguar orët mësimore të paraqitura prej Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni në kërkim të titullit *Profesor ordinar* konfirmon se ato i plotësojnë kriteret për mbrojtje para jurisë. Po ndalemi në disa aspekte që na bëjnë të japim disa reflektime për demonstrimin e aftësive shkencore dhe profesionale të Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni: Mësimdhënia e një gjuhe të huaj trajton një çështje aktuale, temën e përvetësimit të një gjuhe të huaj si një prej kompetencave kyçe, të përcaktuara edhe nga korniza arsimore e BE-së në kontekstin e një bote gjithnjë e më ndërkulturore dhe globale, dhe që si e tillë, mësimdhënia e tij ka rëndësi të veçantë për disa arsye: a) Të mësuarit e një gjuhe të huaj ka kohë që është një aftësi mbarë botërore e konsideruar prioritet, e cila është në qendër të vëmendjes së shoqërive të sotme, perëndimore dhe lindore; b) Të mësuarit e një gjuhe të huaj në shkollë dhe jashtë saj është shndërruar në një shqetësim psiko-pedagogjik sidomos në këto dy dekadat e fundit edhe në Maqedoni; c) Të mësuarit e një ose më shumë gjuhëve të huaja në shkollë dhe jashtë saj ka ndikimet e veta në jetën e individëve, por edhe të shoqërisë dhe prandaj fokusi në mësimdhënien e tij është ndihmues në zgjidhjen e problematikave ekzistuese.

### ***Metodat e përdorura***

Të gjitha leksionet ishin të përgatitura me PowerPoint, dallohej përditësimi i vazhdueshëm, përdorimi i literaturës bashkëkohore, mësimi interaktiv, jo thjeshtë leksione ex-katedra, etj. Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni iu kushton vëmendje të veçantë zbatimit në praktikë të metodave bashkëkohore dhe alternative, kryesisht metodave me qendër studentin, etj. Vlerat e orëve mësimore që i kemi të vëzhguara te Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni mund të grupohen në disa aspekte që po i përmendim në vazhdim:

### ***Në aspektin informues***

Orët e mësimi treguan se pedagogu ka një informacion të gjerë për kontributet teorike për konceptimin e mësimdhënies në gjuhë të huaj, si dhe për zhvillimin e aftësive të komunikimit gjuhësor në komponentët bazë: të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të lexuarit, duke u ndalur në raportet me gjuhën angleze. Kontributet teorike u përzgjedhën dhe integruan mjaft mirë në funksion të qëllimit të mësimi. Mësimdhënia e tij tregoi nivelin e lartë të përvetësimit të informacionit për kërkimet dhe studimet e kryera në fushën e gramatikës nga institucione, organizata dhe studiues të ndryshëm. Mësimdhënia dha për të gjithë të pranishmit një informacion konkret nga konteksti lokal, i mbledhur në punën e gjatë të kandidatit profesor në fushën e gramatikës së gjuhës angleze.

### ***Në aspektin shkencor***

Orët e mësimit ishin të ndërtuara mbi bazën e metodologjive bashkëkohore, të përcaktuara në shërbim të detyrës mësimdhënëse dhe nxënies, si dhe tematikës së trajtuar. Mësimdhënia e Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni garanton besueshmëri të përmbajtjes duke u përpjekur kështu të përfshijë çështjet më përfaqësuese të gramatikës së gjuhës së huaj, në këtë rast asaj angleze. Rezultatet e mësimit pasqyrojnë me përpikëri perceptimet e objekteve dhe subjekteve të mësimit.

### ***Në aspektin praktik***

Mësimdhënia e demonstruar nga Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni ka vlera praktike për studentët, pedagogët dhe didaktët e arsimit, për specialistët e arsimit, për hartuesit e teksteve shkollore gjegjësisht të gramatikës së gjuhës angleze, për mësuesit e niveleve të tjera të shkollimit, prindërit dhe gjithë të interesuarit e çështjes së mësimdhënies. Mësimdhënia e prezantuar mund të përfshihet në rekomandimet që ndihmojnë në aktivizimin e strategjive për hartimin dhe mësimdhënien e manualeve të mësuesve të gjuhës angleze dhe të gjuhëve të huaja në përgjithësi, rekomandime që do të ishin një ndihmesë konkrete për përmirësimin e veprimtarisë së institucioneve arsimore dhe atyre që bashkëpunojnë me to në këtë fushë, por edhe të mësuesve që ndeshen me problematikat e të mësuarit të gramatikës së gjuhës së huaj.

## **Përfundim dhe propozim**

Komisioni recenzues pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatit i cili ka konkurruar, dhe bazuar në nevojat për zgjedhje-rizgjedhje në thirrje mësimore shkencore, mësimore dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, dhe nga e sipërpërmendura mund të përfundojmë se me veprimtarinë e tij të suksesshme në mësimdhënie dhe nivelin e duhur të dijeve, veprimtarisë, interesimit dhe angazhimit të tij në problematikën shkencore, Prof.Assoc.dr. Arburim Iseni i plotëson kushtet ligjore për t'u zgjedhur në thirrjen për të cilën ka konkurruar. Në fushën e mësimdhënies ai posedon aftësi për mësimdhënie cilësore. Punimet shkencore në revista të shquara dhe pjesëmarrja e tij në konferenca ndërkombëtare dhe kombëtare qartë dëshmojnë për profilizimin dhe gatishmërinë për t'i përcjellur çdoherë pyetjet aktuale nga fusha e gjuhësisë angleze, dhe gjithashtu për gatishmërinë për përcjelljen e pyetjeve aktuale edhe përsa i përket problematikës historiko-letrare të gjuhës angleze. Këto njohuri ai në mënyrë shumë të suksesshme i implementon në praktikën e deritashme të tij shkencore dhe hulumtuese në skenën vendore dhe ndërkombëtare. Besojmë se zgjedhja e tij do të sjellë shumë rezultate në nxitjen e proceseve edukative, shkencore dhe hulumtuese në programin studimor të gjuhës dhe letërsisë angleze pranë Universitetit të Tetovës. Për këtë arsye është nder dhe kënaqësi për ne t'i propozojmë Këshillit Mësimor-Shkencor pranë Fakultetit Filologjik, programit studimor të gjuhës dhe letërsisë angleze, Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës që:

1. Prof.Assoc.dr. Arburim Isenin të zgjedh në thirrjen Mësimore-Shkencore **Profesor ordinar** pranë Universitetit të Tetovës, Fakulteti Filologjik, në fushën e gjuhësisë angleze për lëndët: **Gramatika, Semantika, Semiotika, Sintaksa (64018** – Morfologji e gjuhës angleze I, Morfologji e gjuhës angleze II), dhe **Të tjera (64029** - Shkrim akademik III, Shkrim akademik IV) nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas *Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit*)

### **Komisioni recenzues:**

1. **Prof.dr. Florim Ajdini**, profesor ordinar – kryetar

Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës

---

2. **Prof.dr. Isa Spahiu**, profesor ordinar – anëtar

Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës

---

3. **Prof.dr. Berton Sulejmani**, profesor ordinar – anëtar

Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës

---

## V. FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE

Në shtojcat e mëposhtme është bashkangjitur formulari për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidati Arburim ISENI ka grumbulluar gjithsej **875.95** pikë, edhe atë për: veprimtarinë mësimore-shkencore **557.95** pikë, veprimtarinë shkencore-hulumtuese **270**, veprimtarinë profesionale-aplikative **22** pikë dhe veprimtarinë me interes më të gjërë **26** pikë.

Referencat profesionale të kandidatit për zgjedhjen në thirrje	Pikët
Veprimtaria mësimore-shkencore	557.95
Veprimtaria shkencore-hulumtuese	270
Veprimtaria profesionale-aplikative	22
Veprimtaria me interes më të gjërë	26
<b>Gjithsej</b>	<b>875.95</b>

### SHTOJCË

#### PËR RECENSIONIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

**Kandidati:** Arburim Iseni

**Institucioni:** Fakulteti Filologjik-Universiteti i Tetovës, Tetovë

**Lëmi shkencore:** *Morfologji e gjuhës angleze I* (semestri dimëror), *Morfologji e gjuhës angleze II* (semestri veror), *Shkrim akademik III* (semestri dimëror), *Shkrim akademik IV* (semestri veror).

#### I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE - (2019-2024)

Nr.rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
<b>1. Mbajtja e ligjëratave (Lëndët ne ciklin e parë të studimeve)</b>		
<b>Programi studimor – Gjuhë dhe letërsi angleze</b>		
1.1	<b>Përgatitje të lëndëve të reja – (ligjerata)</b>	<b>1.5</b>
1.2	Gramatika e gjuhës angleze – Morfologjia I (ligjerata)	2×15×4×0.04=4.8
1.3	<b>Përgatitje të lëndëve të reja (ushtrime)</b>	<b>1.5</b>
1.4	Gramatika e gjuhës angleze – Morfologjia I (ushtrime)	2×15×4×0.03=3.6
1.5	<b>Përgatitje të lëndëve të reja (ligjerata)</b>	<b>1.5</b>
1.6	Gramatika e gjuhës angleze – Morfologjia II – (ligjerata)	2×15×4×0.04=4.8
1.7	<b>Përgatitje të lëndëve të reja (ushtrime)</b>	<b>1.5</b>
1.8	Gramatika e gjuhës angleze – Morfologjia II (ushtrime)	2×15×4×0.03=3.6
1.9	<b>Përgatitje të lëndëve të reja (ligjerata)</b>	<b>1.5</b>
1.10	Shkrim akademik III (ligjerata)	2×15×4×0.04=4.8
1.11	<b>Përgatitje të lëndëve të reja (ushtrime)</b>	<b>1.5</b>
1.12	Shkrim akademik III (ushtrime)	1×15×4×0.03=1.8
1.13	<b>Përgatitje të lëndëve të reja (ligjerata)</b>	<b>1.5</b>
1.14	Shkrim akademik IV (ligjerata)	2×15×4×0.04=4.8
1.15	<b>Përgatitje të lëndëve të reja (ushtrime)</b>	<b>1.5</b>
1.16	Shkrim akademik IV (ushtrime)	1×15×4×0.03=1.8
1.17	Konsultime me studentë	200×4×0.002=1.6
<b>2. Mbajtja e ligjëratave (Lëndët ne ciklin e dytë të studimeve) II</b>		
2.1	<b>Përgatitje të lëndëve të reja - (ligjerata)</b>	<b>1.5</b>
2.2	Morfologjia dhe hulumtimi morfologjik sintaksor (ligjerata)	2×15×3×0.05=4.5
2.3	<b>Përgatitje të lëndëve të reja (ushtrime)</b>	<b>1.5</b>
2.4	Morfologjia dhe hulumtimi morfologjik sintaksor (ushtrime)	1×15×3×0.05=2.25
2.5	<b>Përgatitje të lëndëve të reja (ligjerata)</b>	<b>1.5</b>
2.6	Aspektet e kulturës në mësimdhënien e gjuhës angleze (ligjerata)	2×15×3×0.05=4.5
2.7	<b>Përgatitje të lëndëve të reja (ushtrime)</b>	<b>1.5</b>
2.8	Aspektet e kulturës në mësimdhënien e gjuhës angleze (ushtrime)	1×15×3×0.05=2.25

2.9	<b>Përgatitje të lëndëve të reja (ligjerata)</b>	<b>1.5</b>
2.10	Romani modern anglez (ligjerata)	2×15×3×0.05=4.5
2.11	<b>Përgatitje të lëndëve të reja (ushtrime)</b>	<b>1.5</b>
2.12	Romani modern anglez (ushtrime)	1×15×3×0.05=2.25
2.13	<b>Përgatitje të lëndëve të reja (ligjerata)</b>	<b>1.5</b>
2.14	Përdorimi i letërsisë në mësimdhënien e gjuhës angleze si gjuhë e huaj (ligjerata)	2×15×3×0.05=4.5
2.15	<b>Përgatitje të lëndëve të reja (ushtrime)</b>	<b>1.5</b>
2.16	Përdorimi i letërsisë në mësimdhënien e gjuhës angleze si gjuhë e huaj (ushtrime)	1×15×3×0.05=2.25
2.17	<b>Përgatitje të lëndëve të reja (ligjerata)</b>	<b>1.5</b>
2.18	Analizë kontrastive e strukturës morfologjike të fjalëve (ligjerata)	2×15×3×0.05=4.5
2.19	<b>Përgatitje të lëndëve të reja (ushtrime)</b>	<b>1.5</b>
2.20	Analizë kontrastive e strukturës morfologjike të fjalëve (ushtrime)	1×15×3×0.05=2.25
2.21	Mentor i komisionit për mbrojtje të temave deridiplomike	20x0.2=4
2.22	Mentor i komisionit për mbrojtje të temave të magjistraturës	30×15×4×0.03=3.6
2.23	Kryetar i komisionit për mbrojtje të temave të magjistraturës	20x1.5=30
2.24	Anëtar i komisionit për mbrojtje të temave të magjistraturës	20x0.5=10
2.25	Recensione të punimeve shkencore (SCI/CA)	20x2=40
2.26	Numri citime të punimeve 1 citim x 1 pikë	385
2.27	<b>Skripta interne për studentët</b>	
2.28	English Morphology	4
2.29	A Modern English Grammar	4
2.30	Basics of English Grammar	4
2.31	The Origin and History of the English Language	4
2.32	Academic Writing	4
<b>Gjithsej</b>		<b>557.95</b>

## II. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE - (2019-2024)

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
<b>2. Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë shkencore/profesionale të recenzuara nga bord ndërkombëtar (me faktor impakti)</b>		
<b>2019</b>		
2.1	Iseni, A., Mehmedi, A., Iseni, B., & Ismailov, G. M. (2019). RUSSIAN-INFLUENCED ENGLISH IN ANTHONY BURGESS'S A CLOCKWORK ORANGE. Russian Linguistic Bulletin, (4), 4-6.	4
2.2	Kurti, B., & Iseni, A. (2019). The Unique Political Attributes Of The United States'system Of Governance. Angloamericanae Journal (AAJ), 4(1), 17-28.	4
2.3	Bajrami, D., Iseni, A., & Topko, A. (2019). Subversion-The Secret Power of the Message Enlaced with the Power of the Internet and Information Technology. Khazar Journal of Humanities and Social Sciences, 22(3), 60-70.	4
<b>2020</b>		
2.4	Kurti, B., & Iseni, A. (2020). SETBACKS OF ALBANIA'S EU INTEGRATION PROCESS. Angloamericanae Journal (AAJ), 5(1), 10-21.	4
2.5	Hossain, A., & Iseni, A. (2020). Manifestations of poverty in world literature. ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies, 9(2), 10-28.	4
<b>2021</b>		
2.1	Bakui, D., Iseni, A., & Mehmedi, A. (2021). Prejudices And Stereotypes Between Albanians And Macedonians In Relation With Those Between Arbëreshë And Italians.	4
2.2	Spahiu, I., Iseni, A., Dreshaj, N., Çesko, H., & Krasniqi, I. (2021). The Use Of New Technologies In Learning English In The Age Of COVID-19. ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies, 10(5), 35-48.	4
2.3	Spahiu, I., Kryeziu, N., Iseni, A., & Karjagdiu, L. (2021). An Approach to English as a Second Language Acquisition Through the Use of Translation Among Students at University of Tetova. Turkish Online Journal of Qualitative Inquiry, 12(6).	4
2.4	Kántás, B., & Iseni, A. (2021). Translations of the Translation. ANGLISTICUM. Journal of the	4

	Association-Institute for English Language and American Studies, 10(7), 11-18.	
2.5	Hossain, A., & Iseni, A. (2021). RETHINKING SUBALTERN, BORDERS, AND BORDERLANDS IN INDIAN AND ALBANIAN LITERATURE IN ENGLISH. ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies, 10(8), 37-48.	4
<b>2022</b>		
2.1	Iseni, A. (2022). Class-Changing Derivational Affixes. ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies, 11(8), 52-84.	4
2.2	Mehmedi, A., Iseni, A., & Hoxhaj, A. (2022). Important Aspects of English poetry in the age of modernism. Angloamerican Journal (AAJ), 7(1), 1-10.	4
2.3	Mikeli-Vata, R., & Iseni, A. (2022). Folklore And the Fantastic Element as A Form of Intertext in The Folktales of Mitrush Kuteli. Journal of Positive School Psychology, 7662-7668.	4
2.4	Kurti, B., & Iseni, A. (2022). THE TRANSFORMATION OF THE CIA FROM INTELLIGENCE GATHERING AGENCY INTO COVERT ACTIONS, 1947-1953. International Journal of Social Sciences & Humanities (IJSSH), 7(1), 41-54.	4
2.5	Kurti, B., & Iseni, A. (2022). WINSTON CHURCHILL AND EAST-WEST DETANTE-The efforts to end the Cold War, 1950-1953. ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies, 11(11), 68-87.	4
2.6	Mehmedi, A., Iseni, A., & Hoxhaj, A. (2022). USING JD SALINGER'S THE CATCHER IN THE RYE IN THE CLASSROOM. ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies, 11(9), 25-35.	4
2.7	Iseni, A. (2022). LANGUAGE AND STYLE IN WILLIAM BUTLER YEATS'S SELECTED POEMS: "Adam's Curse", "Easter, 1916", "The Second Coming" and "Sailing to Byzantium". ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies, 11(7), 109-126.	4
2.8	Koceva, T. I., & Iseni, A. (2022). MACEDONIAN STUDENTS' ATTITUDES AND PREFERENCES OF ENGLISH AS A SECOND LANGUAGE TO ERRORS AND MISTAKES. ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies, 11(3), 17-25.	4
2.9	Vata, R., & Iseni, A. (2022). Dritero Agolli—The Writer of Tradition who Enriched the Albanian Vocabulary. Journal of Positive School Psychology, 6(3), 5057-5061.	4
<b>2023</b>		
2.1	Iseni, A., Karjagdiu, L., & Mahmudi, R. (2023). THE PATH OF THE HERO BETWEEN TRIAL AND ADVENTURE. KNOWLEDGE-International Journal, 58(5), 643-646.	4
2.2	Iseni, A., Ejupi, S., & Memeti, S. I. (2023). THE DYNAMICS OF GENDER AND RELATIONSHIPS IN DH LAWRENCE'S WOMEN IN LOVE. KNOWLEDGE-International Journal, 61(5), 883-888.	4
2.3	Iseni, A., Bajrami, D., Aliti, A., & Deari, A. (2023). THE CONTRIBUTION OF ENGLISH TO THE DEVELOPMENT OF CROSS-CULTURAL RELATIONSHIPS—CREATING BONDS BETWEEN ENGLISH AND ALBANIAN CULTURE. KNOWLEDGE-International Journal, 61(5), 949-953.	4
2.4	Iseni, A., & Rexhepi, A. (2023). Prefixes of Germanic origin. ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies, 12(1), 40-48.	4
2.5	Iseni, A., & Ejupi, S. (2023). MOST COMMON NEOLOGISMS WHICH EMERGED DURING AND IN THE WAKE OF COVID-19. ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies, 12(7), 32-39.	4
2.6	Iseni, A., Aliti, A., & Deari, A. (2023). THE EFFECTS OF CONTINUOUS ASSESSMENT ON STUDENTS' ERRORS AND MISTAKES. KNOWLEDGE-International Journal, 58(2), 381-385.	4
2.7	Iseni, A., & Mikeli, R. V. (2023). ALBANIAN CUSTOMARY LAW, ANGLO-SAXON LAW AND THE OLD WEST: HANDLING THE LAW ON YOUR OWN. Angloamerican Journal (AAJ), 8(1), 50-58.	4
2.8	MILEVA-BLAŽIĆ, M., & Iseni, A. (2023). RELIGIOUS MOTIFS IN THE FAIRY TALES OF OSCAR WILDE. Filologija: International Journal of Human Sciences, 11.	4
2.9	Blažić, M. M., & Iseni, A. (2023). Slovenian fairy tales in European context. International Journal of Social Sciences & Humanities (IJSSH), 8(2), 9-20.	4
2.10	Kurtishaj, L., & Iseni, A. (2023). THE HISTORY OF BLOOD FEUDS CUSTOMARY LAW (THE KANUN) AND BLOOD FEUDS. KNOWLEDGE-International Journal, 61(1), 299-302.	4



2.11	Bledar, K., & Arburim, I. (2023). The School of Athens, the Philosophical Artwork that Conveys All Human Knowledge. <i>International Journal of Cognitive Research in Science, Engineering and Education</i> , 11(1), 165-172.	6
2.12	Blažič, M. M., & Iseni, A. (2023). RELIGIOUS MOTIFS IN THE GRIMMS' FAIRY TALES. <i>ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies</i> , 12(4), 34-50.	4
2.13	Blažič, M. M., & Iseni, A. (2023). Slovenian fairy tales in European context. <i>International Journal of Social Sciences &amp; Humanities (IJSSH)</i> , 8(2), 9-20.	4
2.14	Blažič, M. M., & Iseni, A. (2023). A millennium of One thousand and one nights. <i>International Journal of Social Sciences &amp; Humanities (IJSSH)</i> , 8(2), 21-26.	4
2.15	Blažič, M. M., & Iseni, A. (2023). MULTICULTURAL CHILDREN'S LITERATURE. <i>ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies</i> , 12(6), 11-23.	4
2.16	Blažič, M. M., & Iseni, A. (2023). IMAGE OF THE CHILD IN SLOVENIAN CHILDREN'S LITERATURE. <i>ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies</i> , 12(5), 30-47.	4
2.17	Blažič, M. M., Bedenk, K., & Iseni, A. (2023). SLOVENE WOMEN FAIRY TALE AUTHORS. <i>ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies</i> , 12(4), 25-33.	4
2.18	Blažič, M., & Iseni, A. (2023). Mapping cultural heritage in an international context-the Slovenian unique-painted beehive panels (using ICT in the classroom). <i>ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies</i> , 12(12), 11-19.	4
2.19	Blažič, M., & Iseni, A. (2023). Views on the picturebook. <i>ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies</i> , 12(11), 42-51.	4
2.20	Blažič, M. M., & Iseni, A. (2023). Comparative analysis of youth texts by Oscar Wild and Ciril Kosmač. <i>ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies</i> , 12(10), 47-53.	4
2.21	Bajrami, R., & Iseni, A. (2023). PEER EVALUATION'S IMPACT ON EFL LEARNERS' LANGUAGE LEARNING, MORPHOLOGY UNDERSTANDING, AND VOCABULARY ACQUISITION. <i>ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies</i> , 12(2), 42-47.	4
2.22	Bajrami, D., Paneva, H., Iseni, A., Aliti, A., Deari, A., & Mikeli, R. Fake news as a tool for manipulation during the Covid-19.	6
<b>2024</b>		
2.1	Kurti, B., & Iseni, A. (2024). UNITED STATES FOREIGN INTERVENTIONS IN ITALY AND KOREA. <i>Angloamericanae Journal (AAJ)</i> , 9(1), 9-15.	4
2.2	Blažič, M. M., & Iseni, A. (2024). WOMAN STORYTELLING-CASE STUDIES OF PHILOMENE AND SCHECHEREZADE. <i>ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies</i> , 13(2), 18-24.	4
2.3	Afrim Aliti, Demush Bajrami, Arburim Iseni, & Ardian Deari. (2024). Teaching and Analysing Adjective Formation Suffixes in English and Albanian. <i>The International Journal of Learner Diversity and Identities (IJLDI)</i> , 31(1)	6
2.4	Iseni, A., & Iseni, B. (2024). THE IMPACT OF NEOLOGISMS ON LANGUAGE AND COMMUNICATION. <i>KNOWLEDGE-International Journal</i> , Vol. 64.	4
2.5	Blažič, M. M., & Iseni, A. (2024). RELIGIOUS MOTIFS IN THE FAIRY TALES OF HANS CHRISTIAN ANDERSEN. <i>PHILOLOGIST-Journal of Language, Literature, and Cultural Studies</i> , 15(29). <a href="https://filolog.rs.ba/index.php/filolog">https://filolog.rs.ba/index.php/filolog</a>	6
<b>Gjithsej</b>		<b>192</b>

<b>Punime me rezultate të dalluara hulumtuese të botuara në antologji të konferencave shkencore profesionale - (2019-2024)</b>		<b>Pikët</b>
2.1	Tafani, V., Iseni, A., & Iseni, B. THE INCORPORATION OF TEACHING CULTURE WITH TECHNOLOGY ENHANCES LEARNING ENGLISH AS A FL. <i>ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies</i> , 8. ISBN: 978-608-66191-3-8. IMSC-2019, September 28, 2019. Tetovo. North Macedonia.	6
2.2	THE INFLUENCE OF THE ARABIAN NIGHTS ON ENGLISH LITERATURE 3rd International Multidisciplinary Scientific Video Conference 2020, ISBN: 978-608-66191-	6

	4-5, IMSC-2020, November, 2020. Tetovo. North Macedonia.	
2.3	DRITERO AGOLLI – THE WRITER OF TRADITION THAT ENRICHED THE ALBANIAN VOCABULARY ISBN: 978-608-66191-5-2 IMSC-2021, December, 2021. Tetovo. North Macedonia.	6
2.4	SIMILARITIES AND DIFFERENCES BETWEEN THE NORMS OF THE CANON OF LEKE DUKAGJINI AND THE AREAL OF WESTERN CODES ISBN: 978-608-66191-5-2, IMSC-2021, December, 2021. Tetovo. North Macedonia.	6
2.5	Iseni, A., & Ejupi, S. (2023). MOST COMMON NEOLOGISMS WHICH EMERGED DURING AND IN THE WAKE OF COVID-19. ISBN: 978-608-66191-8-3 IMSC-2022, Tetovo. North Macedonia.	6
2.6	Iseni, A., Bajrami, D., Aliti, A., & Deari, A. (2023). THE CONTRIBUTION OF ENGLISH TO THE DEVELOPMENT OF CROSS-CULTURAL RELATIONSHIPS — CREATING BONDS BETWEEN ENGLISH AND ALBANIAN CULTURE, XLIII International Scientific Conference, KNOWLEDGE IN PRACTICE (December, 14 – 17. 2023) Bansko, Bulgaria.	6
2.7	Iseni, A., Ejupi, S., & Ibraimi Memeti, S. (2023). THE DYNAMICS OF GENDER AND RELATIONSHIPS IN D.H. LAWRENCE’S WOMEN IN LOVE, XLIII International Scientific Conference, XLIII International Scientific Conference, KNOWLEDGE IN PRACTICE (December, 14 – 17. 2023) Bansko, Bulgaria.	6
2.8	Kurtishaj, L., & Iseni, A. (2023). THE HISTORY OF BLOOD FEUDS CUSTOMARY LAW (THE KANUN) AND BLOOD FEUDS, XLIII International Scientific Conference, KNOWLEDGE IN PRACTICE (December, 14 – 17. 2023) Bansko, Bulgaria.	6
2.9	Iseni, A., Aliti, A., & Deari, A. (2023). THE EFFECTS OF CONTINUOUS ASSESSMENT ON STUDENTS’ ERRORS AND MISTAKES, 41st International Conference - TEACHER OF THE FUTURE, 8-11 June 2023, Budva, Montenegro	6
2.10	Blažić, M. M., & Iseni, A. (2023). RELIGIOUS MOTIFS IN THE FAIRY TALES OF HANS CHRISTIAN ANDERSEN, Seminari i XVII i Albanologjisë, Universiteti Shtetëror i Tetovës	6
2.11	Iseni, A., Karjagdiu, L., & Mahmudi, R. (2023). THE PATH OF THE HERO BETWEEN TRIAL AND ADVENTURE, 41st International Conference - TEACHER OF THE FUTURE, 8-11 June 2023, Budva, Montenegro	6
2.12	Iseni, A., & Iseni, B. (2024). The Impact Of Neologisms On Language And Communication. 45th International Scientific Conference THE TEACHER OF THE FUTURE. 23-26.05.2024, Budva, Montenegro	6
2.13	Blažić, M. M., & Iseni, A. (2024). "Comparative Analysis of the Character of the Witch in Russian and Slovenian Fairy Tales - A Case Study: Yaga Baba and Pehta" III International Conference "Digital Didactics" organised by Perm State University, Russia	6
<b>Gjithsej</b>		<b>78</b>

### III. VEPRIMTARIA PROFESIONALE – APLIKATIVE (2019-2024)

Nr.rendor	Emrimi i aktivitetit:	Pikët
<b>III. Koordinator për përgatitjen e elaboratit për program të ri studimor</b>		
3.1	Përktim të një antologjie nga anglishtja në shqip	3
3.2	Lektorim i punimve shkencore në gjuhën angleze	10x1=10
<b>Pjesëmarrje në aktivitete promotive në Fakultet/Instucion</b>		
3.3	Promovim i Universitetit të Tetovës - 2024	1
3.4	Mirënjohje nga Universiteti i Tetovës për promovim të fakulteteve të maturantët.	1
<b>Pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare dhe recension</b>		
3.5	Anëtar i këshillit organizativ në konferencë ndërkombëtare	2
3.6	Anëtar i këshillit organizativ në konferencë rajonale	2
3.7	Anëtar i komisioneve për rizgjedhje në thirrje mësimore-inordinar	2
3.8	Anëtar i këshillit mësimor-shkencor	1
<b>Gjithsej</b>		<b>22</b>

#### IV. VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJËRË (2019-2024)

Nr.rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
<b>AD indeksimi shkencor</b>		
4.1	World Scientists - AD Scientific Index – Ranking for Scientist <a href="https://www.adscientificindex.com/scientist/arburim-iseni/4712757">https://www.adscientificindex.com/scientist/arburim-iseni/4712757</a>	4
<b>Redaktor në revista shkencore profesionale</b>		
4.2	Redaktor përgjegjës dhe themelues i revistës ndërkombëtare <i>ANGLISTICUM</i> . E-ISSN: 1857-8187. P-ISSN: 1857-8179	3
4.3	Redaktor përgjegjës i revistës ndërkombëtare <i>JOURNAL OF LANGUAGE AND LINGUISTICS IN SOCIETY (JLLS)</i> ISSN 2815-0961	3
4.4	Redaktor i revistës ndërkombëtare për edukim <i>JOURNAL OF EDUCATION</i> ISSN: 2347-8225	3
4.5	Redaktor i revistës ndërkombëtare për edukim <i>ICT &amp; INNOVATIONS IN EDUCATION</i> ISSN: 2321-7189	3
<b>Anëtar në revista shkencore profesionale</b>		
4.6	Anëtar i grupit hulumtues për mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë pranë Fakultetit të Edukimit, Universiteti Murcia, Spanjë	1
4.7	Anëtarë i komitetit redaktues në revistës prestigjioze ndërkombëtare <i>Porta Linguarum</i> ISSN: 16977467	1
4.8	Anëtar i bordit redaktues në revistën ndërkombëtare <i>Language Testing in Asia</i> ISSN: 2229-0443	1
4.9	Anëtar i këshillit redaktues pranë revistës prestigjioze ndërkombëtare <i>American Journal of Educational Research</i> , ISSN: 2327-6150	1
4.10	Anëtarë i këshillit redaktues pranë revistës prestigjioze ndërkombëtare <i>Journal of Education and Practice</i> ISSN: 2310-3868	1
4.11	Anëtar në redaksinë e revistës ndërkombëtare për shkencë shoqërore dhe humane <i>American Journal of Social Issues and Humanities</i> ISSN: 2276-6928	1
4.12	Anëtar në redaksinë e revistës ndërkombëtare për shkencë dhe teknologji inovative <i>Journal of Science and Innovative Technologies</i> e-ISSN 2616-4418; p-ISSN: 2521-1447	1
<b>Recenzent në revista shkencore profesionale</b>		
4.13	Recenzent në redaksinë e revistës ndërkombëtare <i>Teaching English with Technology</i> ISSN 1642-1027	1
<b>Anëtar komisioni, recenzent</b>		
4.14	Anëtar i komisionit për transfer të studentëve pranë programit studimor Gjuhë dhe letërsi angleze	1
4.15	Recenzent për autoreferatin e kandidatit për PhD Saporov Salamaton me temë: “ <i>The conceptual basis of the formation of comparative adjectival phrases and their lexical-semantic features (on the example of English and Karakalpak languages)</i> ”	1
<b>Gjithsej</b>		<b>26</b>
Vlersimi i përgjithshëm dhe pikët:		875.95

#### Komisioni recenzues:

1. **Prof.dr. Florim Ajdini**, profesor ordinar – kryetar  
Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës

2. **Prof.dr. Isa Spahiu**, profesor ordinar – anëtar  
Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës

3. **Prof.dr. Berton Sulejmani**, profesor ordinar – anëtar

